

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, përmes gjyqtarës Mirvete Alidema me bashkëpunëtorin profesional Baki S., në çështjen juridike të paditësit S. Sh. nga fsh. T. Komuna e P., ndajë të paditurit Sh. F. nga fsh. Zh. Komuna e Gj., me bazë juridike- kompenzim i dëmit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtimin kryesor dhe publik të datës 25.10.2016, më datën 15 nëntor 2016 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit S. Sh. nga fshati T., Komuna e P., për kompensimin e dëmit, meqë nuk është vërtetuar që i padituri Sh. F. nga fshati Zh. Komuna e Gj., me kontratën me nr. serik ... të dt. ... 2010, veturën e tij të udhëtarëve të markës "...", me targa të Kosovës ... KS ... ia ka shitur paditësit, me çmimin prej 2.300 € (dymijë e treqindë euro) të falsifikuar numrin e shasisë, me çka kinse i padituri, paditësin e ka mashtruar duke ia fshehur të metat, që automjeti i ka pasur për qarkullimin në komunikacionin rrugor si dhe ka kërkuar që të detyrohet i padituri, që paditësit t'ia paguaj dëmin në lartësi prej 2.300 € (dymijë e treqindë euro), me kamatë të llogaritur prej 27 shtator 2010 e deri në kompenzimin e plotë.

II Secila palë i bartë vetë shpenzimet e procedurës, kurse paditësi është i detyruar që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 50 euro në emër të përpilimit të këtij aktgjykimi në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcnimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1. Kronologjia e çështjes

1.1. Pas kthimit të çështjes në rigjykim nga Gjykata e Apelit të Kosovës, gjykata ka vepruar sipas vërejtjeve të tyre dhe i ka dëgjuar palët ndërgjyqëse dhe atë S. Sh. nga fsh. T., Komuna e P. dhe Sh. F. nga fsh. Zh. Komuna e Gj. .

Paditësi S. Sh. në seancën gjyqësore të datës ... 2016, ka deklaruar se mbetet pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke theksuar që kur e kishte blerë automjetin-kombi nga Sh. F., e kishte pyetur disa herë se a ishte kombi në gjendje të rregullt si për nga dokumentacioni ashtu edhe nga gjendja teknike. Dhe ashtu e kishte pranuar automjetin me ndërruesin e shpejtësisë jo në rregull, ndërsa dokumentacioni i automjetit kishte qenë në rregull. Pasi që e kishte blerë kombin, dy javë me radhë e kishte rregulluar ndërruesin e shpejtësisë e me pas te njëjtin automjet ia kishte shitur personit të tretë me emër O. M. nga P. O. pas dy dite kishte shkuar te ai dhe i kishte treguar që kombi nuk ishte në rregull me dokumente. Pas njoftimit për këtë problem nga O., e kishte thirrur në telefon Sh. F. n që të kontaktoj me të dhe se bashku me O. M. kishin shkuar në Gj. që të ballafaqohen me problemin në fjalë. Sh. i është përgjigjur se kombi kishte qenë tërësisht në rregull meqë rast e kishte thirrur pronarin e mëparshëm nga i cili e kishte blerë kombin dhe ish-in marrë vesh që të tre ta dërgojnë automjetin në verifikim në Polici, meqë ishte i bindur se kombi ishte në rregull. Sh. i kishte thene që nëse automjeti nuk ishte në rregull me dokumente do të përgjigjej.

Te njëjtën dite O. M. e kishte dërguar ne Stacionin Policor ne Prishtine për ta vërtetuar se a ishte automjeti ne rregull me dokumente, por pas tri javësh apo nje muaji policia e kishin lajmëruar që të shkojnë në stacionin policor per ta parë vetë gjendjen faktike ku edhe aty ne stacionin policor e kishte vërejtur qe numri i karoseris së automjetit të tij i ishte ndërruar dhe ishte vendosur numir i karoserisë së një automjetit tjetër.

Nga aty policët e kishin dërguar lenden ne gjykate dhe kombi i tij ishte konfiskuar.

Ndërkaq i padituri Sh. F. ka deklaruar që kombin e kishte shitur ne P. ne ora ... te mbrëmjes, por saktësisht data nuk i kujtohet dhe për këtë shitblerje paditësi ia kishte dhënë shumën prej 2.200 euro, ndërsa ai ia kishte dhene komplet dokumentacionin dhe i kishte thene se garantoj se dokumentacioni eshte ne rregull.Te njëjtin kombi e kishte regjistruar 6 vite me rradhë në mënyrë të rregullt ku e kishte bërë edhe kontrollimin teknik për të punuar si Taksist. Kombin kur ia kishte shitur S. kishte pasur dy muaj e gjysme regjistrim . Më tutje thekson që S. eshte dashur që ta dërgoj kombin për verifikim menjëherë pas dy ditësh ose te nesërmen, pasi e kishte blerë e jo pasi që kombit i kishte dalë regjistrimi , e ditën e fundit kishte shkuar te ai në Gj. për ti treguar se do ta dërgonte në verifikim se mos e kishte bërë ai apo dikush tjetër falsifikim e dokumentave. Të njëjtën ditë e kishte thirrur edhe personin e trete prej të cilit e kishte blerë kombin i cili i kishte garantuar se nuk kishte bërë kurrfarë falsifikimi dhe kishte propozuar qe automjetin ta dërgojmë ne policin e Gj., por S. i kishte thënë se do ta dërgonte ne P. pasi qe atje behet verifikimi më i shpejtë. Kurse ai kishte garantuar qe falsifikimin nuk e kishte bere ai gjate kohës sa e kishte shfrytëzuar automjetin-kombin ne fjale.

Në shqyrtimin gjyqësor me pajtimin e palëve ndërgjyqëse , gjykata ka lexuar provat e shqyrtuara në procesverbalin e shqyrtimit kryesor të datës 09.09.2013 dhe ate me sa vijon:

-kontratën për shitëblerjen ndërmjetsuese e lidhur në mes shitësit Sh. F. nga fsh.Zh. dhe S. Sh.nga fsh.T. Komuna e Gj. me dt.2010 në Gj.

-Vërtetimi mbi marrjen e veturës nga ana e Njësisë së Hetimeve Rajonale-autokrime dt.06.10.2010 në Prishtinë

Njoftimin me shkrim nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, PPr.nr.1234/11 i dt.17.07.2013,

-Dokumenti mbi regjistrimin e automjeteve me targa ...-KS- ... dhe numër të shasisë ... në emër të Sh. F..

Nga provat e shtjelluara veq e veq në kuptim të nenit 8 të LPK-ës dhe ate:

Nga Kontrata mbi shitblerjen ndërmjetësuese të datës 27.09.2010 gjykata vërteton faktin Sh. F. ia ka shitur veturën "...", blerësit S. Sh.nga fshati T., Komuna e P. në çmimin prej 2.300 € (Dymijë e treqindë Euro).

Nga Vëretimi mbi marrjen e veturës i datës2010 gjykata vërteton faktin se policia ia ka konfiskuara veturën "...”me targa të regjistrimit ... KS ... me nr.të Librezës së Qarkullimit ..., për shkak të dyshimit të falsifikimit të nr.të shasisë.

Nga Njoftimi me shkrim i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, sipas të cilës PTH, në Prishtinë e ka mbyllur rastin me 13.10.2011, gjykata vëreton fatkin se për këtë vepër në çështjen penale fare nuk është vendosur për shkak të parashkrimit relativ e që nënkupton se nuk është vërtetuar se kush e ka bërë falsifikimin e numrit të shasië së automjetit në fjalë në bazë të së cilës edhe do të vendoset mbi kompensimin e dëmit.

Nga katër vëretimet e kontrollimit teknik dhe Libreza e Qarkullimit ..., gjykata vërtetoi faktin se i njëjti 6 vite me radhë e ka bërë kontrollimin teknik dhe regjistrimin e automjetit në mënyrë të rregullt.

Në fjalën përfundimtare paditësi S. Sh. , ka mbetet pranë padisë dhe kërkesë padisë, duke kërkuar që i padituri Sh. të i a paguaj kombin në vlerë prej 2.200 € aq sa e kishte blerë dhe dëmin e pësuar për pesë vite, në vlerë prej 700 € (shtatëqindë) euro si shpenzimet e gjykatës , shpenzimet për padi , shpenzimet për kontratën e automjetit si dhe shpenzimet e rrugës.

Ndërkaq i padituri Sh. F. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk i ka kurrfarë borgji paditësit ngase kombin ia kishte shitur në mënyrë të rregullt me dokumentacion dhe të pa falsifikuar dhe të gjitha paisjet që kishin qenë në kombi.

Gjykata pasi analizoi deklaratën e palëve ndërgjyqëse dhe provat e deponuara në shkresat e lëndës , konstatoi se paditësi me asnjë provë nuk ka arrite ta bindë gjykatën që ta aprovojë kërkesëpadin e paditësit , ashtu që e refuzoi padinë dhe kërkesëpadinë në tersi si të pabazuar .

Vendimi në emër të përpilimit të këtij aktgjykimi është bazuar në mbështje të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore nr. 37/2012 të datës 23 mars 2012.

Nga arsyet e cekura më lartë e në mbështetje të nenin 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**Gjyqtarja,
Mirvete Alidema**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditë, pas ditës së pranimit të vendimit, ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.